



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.264/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Rojet e Nderit” SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore” me nr. të prok: 651-20-592-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Gjilan, më datën: 13.05.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rojet e Nderit” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore” me nr. të prok: 651-20-592-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Gjilan.

II. **ANULOHET**, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore” me nr. të prok: 651-20-592-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Gjilan, dhe **anulohet** në tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta **Ritenderoj** konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: “Rojet e Nderit” SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Rojet e Nderit” SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 23.04.2020 me nr.264/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore” me nr. të prok: 651-20-592-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 9, 10, 27, 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 07.05.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket pretendimit që AK ka lënë shumë paqartësi sa i përket llogaritjes së pagave të punëtorëve se çka mund të llogaritet, po ashtu është krijuar hapësirë e manipulimit nga OE me paga të punëtorëve duke vendosur kriteret të cilat nuk janë të qarta dhe janë në kundërshtim me LPP-në, sidomos me ato që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e OE të rekomanduar për kontratë, Eksperti Shqyrtues një pretendim të tillë pas shqyrtimit të lëndës e gjen si të bazuar. Arsyetimi i një gjetjeje të tillë, vijon si më poshtë:

- Pas shqyrtimit të dosjes, konkretisht specifikimeve teknike, vërehet një diskrepancë e mënyrës së llogaritjes në mes të këtyre të fundit dhe pjesës së përshkrimit të çmimeve. Konform dispozitave ligjore të RRUOPP, gjegjësisht pikave 20.3 dhe 20.4, specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca.
- Përshkrimi i çmimit nuk paraqet një dekompozim të mirëfilltë të pikave duke mos i'u referuar

konkretisht se në cilën pikë nevojiten pozitat e përmendura në tabelë. Po ashtu, çmimi për njësi i caktuar si “çmim për orë” nuk është i arritshëm të merret si mesatare dukë marrë parasysh kalkulimin e orëve të punës në variante të ndryshme. Një njësi matëse e tillë nuk përputhet me shpjegimin e AK-së në Përgjigjen ndaj OE ankues, dukë përmendur *numrin e punëtorëve të cilët janë të nevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit.*

- Variantet e llogaritjes së çmimit për orë duhet dekompozuar në bazë të pikave dhe pozitave të kërkuara, duke detajuar orët e punës nga vet Autoriteti Kontraktues varësisht punës gjatë natës, ditës, vikendit (natën ose/dhe ditën), dhe gjatë festave. Si shembull, orari i punës për sigurim fizik në Sh.F “Abaz Ajeti” me pozitë nr.1 sa i përket objekteve shkollore dhe parashkollore, duhet dekompozuar në orë nate dhe në orë dite, ku po ashtu duhet cekur decitivisht që një orar i tillë vlen për një numër të caktuar të ditëve të javës dhe numri i pozitave (rojeve) të kërkuara nga AK. Sipas Ligjit të Punës, çmimit bazë për orë pune i duhet shtuar 30% ose 50% përgjatë punës natën, respektivisht festave dhe vikendeve, ku duke marrë parasysh një përlllogaritje të tillë është e pamundur të ofertohet mesatarisht si total për të gjitha orët e punës në përgjithësi. *Për faktin që kemi të bëjmë me orë shërbimi të punës së ndryshme në lokacione të ndryshme, të ndara me njësi pune orë, çmimi për një orë pune të ditës duke marrë si vlerë mesatare llogaritjen e orëve shtesë gjatë punës natën, vikendeve dhe festave për një muaj lë hapësirë për hamendje dhe nuk krijon uniformitet në llogaritje. Si i tillë, rezulton në kalkulim të ndryshëm nga operatorë ekonomikë.*
- Kërkesa e Autoritetit Kontraktues sa i përket trajtimit me prioritet ndaj operatorëve ekonomik të cilët marrin për bazë punëtorët të cilët janë veçse të sistemuar në objektet e Komunës për këtë aktivitet të prokurimit, është diskriminues dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Po ashtu, shpjegimi i Autoritetit Kontraktues që për pjesën tjetër të punëtorëve përveç këtyre 48 të cilët janë veçse të angazhuar në objektet e komunës, AK nuk ka kritere për pagat dhe është nën përgjegjësinë e OE çështja e pagës dhe formës së pagesave thërret në hamendje të llogaritjes së çmimit total dhe pamundëson njëtrajshmëri sa i përket mënyrës së llogaritjes nga operatorët ekonomik.

Për faktin që kriteret e përlllogaritjes nuk përputhen me specifikimet teknike, dhe ekziston një diskrepancë sa i përket çmimit njësi si çmim mesatar total dhe si të dekompozuar, korrigjimet në dosjen e tenderit nuk janë të mjaftueshme për sqarim dhe për të krijuar uniformitet në mënyrën e llogaritjes.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e OE ankues si të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore” me nr. të

prokurimit: 651-20-592-2-1-1, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Gjilan*, të anulohet dhe nëse Autoriteti Kontraktues ka nevojë të ri tenderohet. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve, duke marrë parasysh gjendjen faktike të aktivitetit të prokurimit sa i përket përgatitjes jo adekuate të dosjes së tenderit nga AK.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e bazuar dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 07.05.2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë: 12.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.05.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Rojet e Nderit” SH.P.K. – Prishtinë se autoriteti kontraktues ka lënë shumë paqartësi sa i përket llogaritjes së pagave të punëtorëve se çka mund të llogaritet. Më tej, OE ankues shton se është krijuar hapësirë e manipulimit nga OE me paga të punëtorëve duke vendosur kriteret të cilat nuk janë të qarta dhe janë në kundërshtim me LPP-në, sidomos me ato që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues e vlerëson këtë pretendim si të bazuar për faktin se pas shqyrtimit të dosjes të tenderit konkretisht specifikimeve teknike, vërehet një diskrepancë e mënyrës së llogaritjes në mes të këtyre të fundit dhe pjesës së përshkrimit të çmimeve. Konform dispozitave ligjore të RRUOPP, gjegjësisht pikave 20.3 dhe 20.4, specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se përshkrimi i çmimit nuk paraqet një dekompozim të mirëfilltë të pikave duke mos i'u referuar konkretisht se në cilën pikë nevojiten pozitat e përmendura në tabelë. Po ashtu, çmimi për njësi i caktuar si “çmim për orë” nuk është i arritshëm të merret si mesatare dukë marrë parasysh kalkulimin e orëve të punës në variante të ndryshme. Një njësi matëse e tillë nuk përputhet me shpjegimin e AK-së në përgjigjen ndaj OE ankues, dukë përmendur *numrin e punëtorëve* të cilët janë të nevojshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Variantet e llogaritjes së çmimit për

orë duhet dekompozuar në bazë të pikave dhe pozitive të kërkuara, duke detajuar orët e punës nga vet Autoriteti Kontraktues varësisht punës gjatë natës, ditës, vikendit (natën ose/dhe ditën), dhe gjatë festave. Si shembull, orari i punës për sigurim fizik në Sh.F “Abaz Ajeti” me pozitë nr.1 sa i përket objekteve shkollore dhe parashkollore, duhet dekompozuar në orë nate dhe në orë dite, ku po ashtu duhet cekur decidivisht që një orar i tillë vlen për një numër të caktuar të ditëve të javës dhe numri i pozitive (rojeve) të kërkuara nga AK. Sipas Ligjit të Punës, çmimit bazë për orë pune i duhet shtuar 30% ose 50% përgjatë punës natën, respektivisht festave dhe vikendeve, ku duke marrë parasysh një përlllogaritje të tillë është e pamundur të ofertohej mesatarisht si total për të gjitha orët e punës në përgjithësi. *Për faktin që kemi të bëjmë me orë shërbimi të punës së ndryshme në lokacione të ndryshme, të ndara me njësi pune orë, çmimi për një orë pune të ditës duke marrë si vlerë mesatare llogaritjen e orëve shtesë gjatë punës natën, vikendeve dhe festave për një muaj lë hapësirë për hamendje dhe nuk krijon uniformitet në llogaritje. Si i tillë, rezulton në kalkulim të ndryshëm nga operatorë ekonomikë.*

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa e Autoritetit Kontraktues sa i përket trajtimit me prioritet ndaj operatorëve ekonomik të cilët marrin për bazë punëtorët të cilët janë veçse të sistemuar në objektet e Komunës për këtë aktivitet të prokurimit, është diskriminues dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Po ashtu, shpjegimi i Autoritetit Kontraktues që për pjesën tjetër të punëtorëve përveç këtyre 48 të cilët janë veçse të angazhuar në objektet e komunës, AK nuk ka kriteret për pagat dhe është nën përgjegjësinë e OE çështja e pagës dhe formës së pagesave thërret në hamendje të llogaritjes së çmimit total dhe pamundëson njëtrajtshmëri sa i përket mënyrës së llogaritjes nga operatorët ekonomik. Andaj, kriteret e përlllogaritjes nuk përputhen me specifikimet teknike, dhe ekziston një diskrepancë sa i përket çmimit njësi si çmim mesatar total dhe si të dekompozuar, korrigjimet në dosjen e tenderit nuk janë të mjaftueshme për sqarim dhe për të krijuar uniformitet në mënyrën e llogaritjes.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, pretendimet e OE ankues janë të bazuara dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë duhet të anulohet dhe nëse autoriteti kontraktues ka nevojë të njëjtin mund ta ritenderoj konform dispozitave të LPP-së, një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve, duke marrë parasysh gjendjen faktike të aktivitetit të prokurimit sa i përket përgatitjes jo adekuate të dosjes së tenderit nga AK.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues vlerëson se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në bazë të nenit 62 të LPP-së për shkak se

një shkelje e ligjit mund të ndodh. Andaj, ky aktivitet i prokurimit anulohet në tërësi dhe nëse autoriteti kontraktues vazhdon të ketë interes, të njëjtin mund ta ritenderoj konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- "KK Gjilan",
- 1x1 OE- "Rojet e Nderit" SH.P.K. – Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.